

**V E N D I M**  
**Nr. 543, datë 31.10.2002**

**PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**  
**(AFP)**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të krijojnë Komisionin e Akreditimit të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, përbërja, organizimi dhe funksionet e të cilit të përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të të dy ministrave.

2. Komisioni vendos për akreditimin ose jo të institucioneve të AFP-së brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së kërkesës për akreditim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kriteret e përgjithshme për dhënien ose jo të akreditimit janë:

a) Ligjshmëria e institucionit të AFP-së:

- dokumenti i regjistrimit si institucion i AFP-së;

- dokumenti ligjor që i jep të drejtë institucionit të përdorë truallin, ndërtesën dhe mjediset e tjera ndihmëse.

b) Menaxhimi i institucionit të AFP-së:

- struktura organizative e institucionit të AFP-së;

- përshkrimi i funksioneve për çdo njësi organizative;

- përshkrimi i punës për çdo anëtar të personelit;

- dokumenti i planifikimit të veprimtarisë së institucionit;

- rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit;

- rregullorja financiare e institucionit.

c) Përshkrimi i arsimit/formimit profesional që ofron institucioni i AFP-së:

- lista e specialiteteve të arsimit dhe formimit profesional që ofron institucioni;

- programi i përgjithshëm (skeletkurrikula) për secilin arsim/formim;

- programet e lëndëve/ moduleve për secilin arsim/formim;

- përshkrimi i nivelit të pritshëm të arritjeve të nxënësve në fund të arsimit/formimit;

- llojin e dokumentit që lëshon në përfundim të arsimit/formimit.

ç) Personeli i institucionit të AFP-së:

- niveli dhe specialiteti i arsimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit drejtues dhe atij ndihmës;

- niveli dhe specialiteti i arsimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit mësimdhënës;

- numri i personelit, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme;

- struktura e pagave të personelit;

- marrëveshja me sigurimet shoqërore;

- kontratat e punës së personelit;

d) Infrastruktura e institucionit të AFP-së:

- mjediset, orenditë dhe pajisjet në funksion të personelit drejtues dhe atij ndihmës;

- mjediset, orenditë, pajisjet dhe materialet didaktike, në funksion të procesit mësimor, teorik e praktik;

- numri i nxënësve/kursantëve, në raport me mjediset mësimore;

- hapësirat e mjediseve mësimore;

- ndriçimi i mjediseve mësimore;

- masat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit;

- kushtet higjiëno-sanitare.
- 4. Komisioni i Akreditimit angazhon grupe ekspertësh për hartimin e manualit të akreditimit të institucioneve të AFP-së, i cili përmban kriteret e akreditimit, të hollësishme nga pikpamja sasiore e cilësore.
- 5. Manuali i akreditimit të institucioneve të AFP-së miratohet nga Komisioni i Akreditimit.
- 6. Komisioni i Akreditimit mund të ngarkojë ekspertë/grupe ekspertësh për të bërë vlerësimin e institucioneve të AFP-së, që aplikojnë për akreditim.
- 7. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit të Akreditimit dhe të ekspertëve të jashtëm bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 8. Akreditimi jepet për një periudhë trevjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
- 9. Akreditimi hiqet kur shkelen kriteret e përcaktuara. Të drejtën për heqjen e akreditimit e ka komisioni i akreditimit.
- 10. Tarifa për akreditimin është 10 000 lekë.
- 11. Vendimi nr.354, datë 12.5.1996 i Këshillit të Ministrave "Për autorizimin dhe mbikëqyrjen e qendrave, publike e private, të formimit profesional" shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Fatos Nano**